



FEDERATA
SHQIPTARE E
FUTBOLLIT

Adresa: Shtëpia e Futbollit,
Rruga: "Liman Kaba", Nr. 5
Kodi Postar 1019, Tirana, Albania

Telefon: +35542 346 601
Fax: +35542 346 609
E-mail: info@fshf.al

Nr. Prot. EXT

Tiranë, më 26/5/2022

Drejtuar: **SH.T.Z. EDI RAMA**
KRYEMINISTËR
KRYEMINISTRIA

Lënda: Falenderimet në kuadër të organizimit të Finales së UEFA Conference League

I nderuar Z. Kryeministër,

Të mërkurën e 25 Majit 2022, në Stadiumin Arena Kombëtare, kulmoi Finalja e UEFA Conference League, me triumfues ekipin e Romës, ku ndoqëm një performancë e një ndeshje spektakolare edhe nga ekipi i Feyenordit.

25 Maji tashmë është skalitur në memorien e Futbollit Europian si finalja e parë e këtij kompeticioni, në historinë Shqipërisë dhe kryeqytetit tonë, Tiranës.

Nga dita e parë besuam në organizimin e këtij eventit sfidues dhe sot jemi krenar që u kthyem në kryeqendrën Europiane, nga ku përçollëm emocione për qindra milion njerëz anembanë botës.

Tirana u shndërrua në shtëpinë e mijëra e mijëra vizitorëve që mbushën sheshet e rrugët tona duke festuar, e sërish treguam se mikëpritja është tipar genetik i kombit tonë.

Jemi të vetëdijshëm që ky sukses, ishte rrjedhojë e një bashkëpunimi të shkelqyer institucional, e një pune të palodhur të çdo punonjësi e zyrtari dhe të një gatishmërie të pakushtëzuar për të nderuar angazhimin e vendit tonë, Shqipërisë.

Ja dolëm të organizojmë një finale të denjë për çdo vend të përparuar Europian, e kuruar në çdo detaj dhe gjejmë rastin të përcjellim një falenderim e mirënjohje të përzemërt!

Në 25 Maj jemi ndjerë të gjithë krenar e fituesi i vërtetë i kësaj finaleje është vendi ynë, Shqipëria.

Me mirënjohje,

Armand DUKA

PRESIDENT
FEDERATA SHQIPTARE E FUTBOLLIT

Sponsor Qëndror



Sponsor Teknik



Prandërrim Sponsor



Sponsor Zyrtarë



UNIONBANK

www.vos.al

